

VENDIM
Nr. 282, datë 1.4.2015

PËR RISHPËRNDARJEN E NUMRIT TË PUNONJËSVE NË NJËSITË E
QEVERISJES QENDRORE, PËR VITIN 2015

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i punonjësve të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave shtohet me 20 veta dhe bëhet, gjithsej, 2164 punonjës.
 2. Numri i punonjësve të Institutit të Statistikave (INSTAT) pakësohet me 20 veta dhe bëhet, gjithsej, 216 punonjës.
 3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Instituti i Statistikave dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama